REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROSEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATES DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dalese / Izlazne; Date / Dana: 02 / 03 / 2026
Nr.Orgv Org jed 01 | Nr.Prot. Br.Prot. 25 | Nr.Faqeve. Br.Strana. 1
Ferizaj - Urosevac

**REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO**
**KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ**

http://kk.rks-gov.net/ferizaj

**KUVENDI I KOMUNËS**
**SKUPSTINA OPŠTINE**
**MUNICIPAL ASSEMBLY**

**01.Nr.25**
**Data: 27.02.2026**

Në bazë të nenit 12 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Nenit 7,8,9 dhe 10 i Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në Komunë si dhe nenit 17 paragrafi 17.1 të Statutit të Komunës së Ferizajt, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 27.02.2026 miratoi këtë:

## VENDIM
## PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E VENDIMIT ME NR: 11 TË DATËS 30.12.2025

**I**

Me këtë Vendim Plotësohet-Ndryshohet Vendimi i datës 30.12.2025 me nr. protokoli 01.Nr.11 vetëm sa i përket anëtarit nga Komiteti Rom ku në vend të:

Xhemajl Jashari, emërohet Luljeta Jashari

**II**

Të gjitha pikat tjera të Vendimit me nr. 01.Nr.11 të datës 30.12.2025 mbesin në fuqi, dhe ky plotësim bëhet për realizimin e kuotës gjinore.

**III**

Për realizimin e këtij vendimi do të kujdeset Kuvendi i Komunës Ferizaj.

**IV**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

**Xhavit Zariqi**

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT - OPSTINA UROSEVAC - MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT - UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dalese / Izlazne: Date / Dana: 02 / 03 / 2026
Nr.Orgv Org jed. 01 | Nr.Prot. Br Prot. 27 | Nr.Faqeve. Br.Strana. 1



**KUVENDI I KOMUNËS**
**SKUPSTINA OPŠTINE**
**MUNICIPAL ASSEMBLY**

**01.Nr.27**
**Data: 27.02.2026**

Në bazë të dispozitave të nenit 12 të Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/15 Qershor 2008), nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës Ferizaj, 01.Nr.50 te datës 28.06.2013 si dhe në bazë të kërkesës së Asociacionit të Komunave të Kosovës, për caktimin e anëtarëve nga radhët e Kuvendit të komunës dhe në bazë të formulës së zgjedhjes së deritanishme, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 27.02.2026 miratoi këtë:

## VENDIM

## PËR CAKTIMIN E ANËTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË FERIZAJT PËR PËRFAQËSUES NË AKK

**I**

Anëtarë të Kuvendit për AKK caktohen:

1. Elbasan Osmani
2. Vanesa Sadriu Topojani
3. Ramadan Ramushi
4. Jehona Mustafa Krasniqi

**II**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

**Xhavit Zariqi**

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dalese / Izlazne: Date / Dana: 02/03/2026
Nr.Orgv Org.red 01 | Nr.Prot. Br.Prot. 28 | Nr.Faqeve. Br.Strana. 1
Ferizaj - Uroševac

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

FERIZAJ

http://kk.rks-gov.net/ferizaj

**KUVENDI I KOMUNËS**
**SKUPSTINA OPŠTINE**
**MUNICIPAL ASSEMBLY**

**01.Nr.28**
**Data: 27.02.2026**

Në bazë të nenit 12 të Ligjit Nr 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale si dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës Ferizaj me Nr: 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 27.02.2026 miratoi këtë:

# VENDIM
## PËR LIRIMIN-FALJEN E QIRASË PËR SHOQATËN "YJET E ZEMRAVE" ME ADRESË NË RR. "URAN TINOVA".

**I**

**APROVOHET**: Lirimi-falja e qirasë për lokalin me Nr. P-72217092-00714-4-4-22-2-0 me adresë në Rr "Uran Tinova" në pronësi të Komunës së Ferizaj.

**II**

Shuma totale e qirasë së falur është 4,712.00 €

**III**

**OBLIGOHET:** Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik të bëjë shlyerjen e obligimeve për Shoqatën e Personave të Zhdukur "Yjet e Zemrave", me numër fiskal 60183035, për shumën e obligimeve të qirasë sipas nenit 2 të këtij vendimi.

**IV**

Arsyeja e lirimit nga pagesa të qirasë për shoqatën e lartcekur është pamundësia financiare e pagesave.

**V**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

**Xhavit Zariqi**

REPUBLIKA E KOSOVËS • KUVENDI I KOMUNËS • SKUPŠTINA OPŠTINE • FERIZAJ UROŠEVAC

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT • OPSTINA UROSEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dalese / Izlazne: Date / Dana: 02 / 03 / 2026
Nr.Orgv Org jed. 01 | Nr.Prot. Br.Prot. 29 | Nr.Faqeve. Br.Strana. 1
Ferizaj - Uroševac

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

http://kk.rks-gov.net/ferizaj

**KUVENDI I KOMUNËS**
**SKUPSTINA OPŠTINE**
**MUNICIPAL ASSEMBLY**

**01.Nr.29**
**Data: 27.02.2026**

Në bazë të dispozitave të nenit 12 të Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/15 Qershor 2008 si dhe bazuar në nenin 11 të Rregullores së datës 11.03.2011, për ndarjen e bursave për student për Vitin shkollor 2025/2026, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajrur me datë 27.02.2026 miratoi këtë:

## VENDIM

## PËR CAKTIMIN E DY ANËTARËVE NGA KUVENDI I KOMUNËS PËR KOMISION PËR NDARJEN E BURSAVE PËR STUDENTË PËR VITIN AKADEMIK 2025/2026

**I**

Me këtë vendim caktohen dy anëtarë të Komisionit për ndarje të bursave për student për vitin akademik 2025/2026:

1. **z. Ridvan Berisha**
2. **z. Hysen Hyseni**

**II**

Komisioni i përmendur në pikën një të këtij vendimi formohet nga Drejtoria për Arsim në përbërje prej shtatë anëtarëve, prej të cilëve, pesë anëtarë janë nga Drejtoria e Arsimit dhe dy anëtarët e përmendur më lartë janë pjesë përbërëse e këtij komisioni të caktuar nga Kuvendi i Komunës.

**III**

Për realizimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës, Kryesuesi i Kuvendit dhe Drejtoria e Arsimit.

**IV**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

**Xhavit Zariqi**

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT • OPSTINA UROSEVAC • MUNICIPALITI OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dalese / Izlazne: Date / Dana: 02 / 03 / 2026
Nr.Orgv 01 | Nr.Prot. 30 | Nr.Faqeve. 2

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

FERIZAJ

http://kk.rks-gov.net/ferizaj

**KUVENDI I KOMUNËS**
**SKUPSTINA OPŠTINE**
**MUNICIPAL ASSEMBLY**

**01.Nr.30**
**Data: 27.02.2026**

Në bazë të nenit 58 pika 1.h.të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 51 pika 2.9, të Statutit të Komunës së Ferizajt 01 Nr.50, i datës 28.06.2013, nenit 4 dhe 14 të Udhëzimit Administrativ Nr,27/2012 MPB- 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 27.02.2026 miratoi këtë:

# VENDIM

## PËR ZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË RINJ TË KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI (KKSB)

**I**

Kuvendi i Komunës aprovon këtë përbërje të re të Këshillit Komunal per Siguri në Bashkësi:

1. Agim Aliu – Kryetar i Komunës së Ferizajt (*Kryesues i KKSB-së*)
2. Ismet Dervishi – Komandant i Stacionit Policor në Ferizaj; *- Anëtar*
3. Kushtrim Neziri – Përfaqësues nga Këshilli i Bashkësisë Islame në Ferizaj; *- Anëtar*
4. Ali Nikolla – Përfaqësues nga Kisha Katolike në Ferizaj; *- Anëtar*
5. Nazmi Berisha - Përfaqësues nga Kisha Protestante Ungjillore në Ferizaj; *- Anëtar*
6. Trajko Vlajkovic - Përfaqësues nga Kisha Ortodokse në Ferizaj; *- Anëtar*
7. Indra Jashari - Përfaqësues nga komuniteti rom; *- Anëtare*
8. Hajriz Haziri - Përfaqësues nga komuniteti ashkali; *- Anëtar*
9. Isa Osmani - Përfaqësues nga komuniteti egjiptian; *- Anëtar*
10. Zoran Maksimovic - Përfaqësues nga komuniteti serb; *- Anëtar*
11. Kryesuesi i Komitetit për Komunitete i Kuvendit të Komunës (*pas caktimit me vendim të Kuvendit); - Anëtar*
12. Besa Çarkaxhiu Bibaj – Zyrtare për Barazi Gjinore në Komunën e Ferizajt; *- Anëtare*
13. Afrim Llabjani – Drejtor i Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Ferizajt; *- Anëtar*
14. Naim Rexhepi - Përfaqësues nga Këshilli i Prindërve të arsimit të Komunës së Ferizajt; *- Anëtar*
15. Vedat Shatri - Përfaqësues nga Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK); *- Anëtar*
16. Hajredin Sylejmani – KLSP Zaskok; *- Anëtar*
17. Fadil Lipovica – KLSP Zona e Qytetit; *- Anëtar*
18. Selvie Ismani – KLSP Bablak; *- Anëtare*

19. Skender Kurti – Sektori i Emergjencave Civile – Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë; - *Anëtar*
20. Muzafer Ramadani - Përfaqësues nga Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim në Komunën e Ferizajt; - *Anëtar*
21. Kenan Gashi – Përfaqësues nga OJQ, mediat lokale, komuniteti i biznesit dhe komuniteti i personave me aftësi të kufizuara. – *Anëtar*

**II**

Këshilli i lartëcekur, punën e tij do ta kryej konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi.

**III**

Për realizimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës.

**IV**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e Komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

**Xhavit Zariqi**

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT • OPSTINA UROSEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATES DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dalese / Izlazne: Date / Dana: 02/03/2026
Nr.Orgv Org jed 01 | Nr.Prot. Br Prot. 31 | Nr.Faqeve. Br.Strana. 1



**KUVENDI I KOMUNËS**
**SKUPSTINA OPŠTINE**
**MUNICIPAL ASSEMBLY**

**01.Nr.31**
**Data: 27.02.2026**

Në bazë të dispozitave nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 te dates 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 27.02.2026 miratoi këtë :

## VENDIM

## PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E VENDIMIT 01.NR.14 TË DATES 31.01.2023.

**I**

Me këtë vendim ndyshohet plotësohet pika V e nenit II të Vendimit 01.Nr.14 të datës 31.01.2023 në vend të perfaqesueses juridike znj. Feride Alija e cila ka ndërruar jetë dhe trashigimtarët kanë shpallur trashigimin sipas Aktvendimit të trashigimisë me Nr.LRP. 17631/2025, Ref. 7503/2025, ashtu që në vend të përfaqësuesit juridik të përcaktuar ne piken 5 te vendimit me nr.01.Nr.14 të dates 31.01.2023 te ndryshohet ne aksionarin e ri te subjektit juridik Besiana GSHPK. Visar Alija me Nr.personal 1001327042.

**II**

Pikat tjera të vendimit nr.01.Nr.14 te datës 31.01.2023 nuk preken nga ky vendim mbesin në fuqi.

**III**

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen : Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës, Gjeodezisë dhe Kadastrit të Komunës së Ferizajt.

**IV**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

**Xhavit Zariqi**

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT • OPSTINA UROSEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATES DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dalese / Izlazne: Date / Dana: 02 / 03 / 2026
Nr.Orgv Org jed. 01 | Nr.Prot. Br Prot. 32 | Nr.Faqeve. Br.Strana. 1
Ferizaj - Uroševac



**KUVENDI I KOMUNËS**
**SKUPSTINA OPŠTINE**
**MUNICIPAL ASSEMBLY**

**01.Nr.32**
**Data: 27.02.2026**

Në bazë të dispozitave nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 te dates 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 27.02.2026 miratoi këtë:

**VENDIM**

**PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E VENDIMIT 01.NR.14 TË DATËS 31.01.2023.**

**I**

Me këtë vendim ndyshohet - plotësohet pika VII e nenit II të Vendimit 01.Nr.14 të datës 31.01.2023.

**II**

Subjektit Juridik N.T.P.Kosova Por, Azem Guta B.I me numer identifikues 811276098 i cili ka qenë deri tani sipas vendimit me numer dhe datë të larteshenuar të ndryshohet në **N.T.P. Kosova Por, Azem Guta shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.**

**III**

Pikat tjera te vendimit Nr.01.Nr.14 të datës 31.01.2023 të cilat nuk preken nga ky vendim mbesim ne fuqi.

**IV**

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen : Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës, Gjeodezisë dhe Kadastrit të Komunës së Ferizajt.

**V**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

**Xhavit Zariqi**

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT • OPSTINA UROSEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATES DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dalese / Izlazne: Date / Dana: 02 / 03 / 2026
Nr.Orgv Org.jed. 01 Nr.Prot. Br.Prot. 33 Nr.Faqeve. Br.Strana. 3
Ferizaj - Uroševac



**KUVENDI I KOMUNËS**
**SKUPSTINA OPŠTINE**
**MUNICIPAL ASSEMBLY**

**01.Nr.33**
**Data: 27.02.2026**

Në bazë të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës së Ferizajt 01.Nr.50 i datës 28.06.2013, konform Rregullorës për Ndarjen e Subvencioneve, neni 21 dhe 21.1, rregullore e miratuar nga Kuvendi i Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 27.02.2026 miratoi këtë:

# V E N D I M
## PËR NDARJEN E SUBVENCIONEVE NË LËMIN E BUJQËSISË PËR VITIN 2026

### I

Me këtë vendim miratohet kërkesa Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë për ndarjen subvencioneve në lëmin e bujqësisë në Komunën e Ferizajt.

### II

Subvencionet e përmendura në pikën një të këtij vendimi do të ndahen si në tabelën më poshtë:

Arsyeshmëria e realizimit të subvencioneve nga Drejtoria për Bujqësisë për Vitin 2026

| | **Shpërndarja e buxhetit** | **Vlera sipas Buxhetit/ €** | **Data e parashikuar e fillimit të prokurimit** |
|---|---|---|---|
| **1** | **Subvencionimi i fermerëve me mekanizim bujqësor** | **185,000.00** | **02.03.2026** |
| **2** | **Subvencionimi i shpezëtarëve prodhues vendor të vezëve për kokë pule** | **35,000.00** | **10.08.2026(bëhet thirrja publike për aplikim)** |
| **3** | **Subvencionimi i fermerëve prodhues të qumështit për litër qumështi të prodhuar** | **120,000.00** | **10.07.2026(bëhet thirrja publike për aplikim)** |
| **4** | **Subvencionimi i fermerëve kultivues të perimeve në serra dhe jashtë tyre me pajisje** | **160,000.00** | **10.03.2026** |
| **5** | **Kompensimi i dëmeve nga fatkeqësitë natyrore** | **100,000.00** | **Pa procedurë të prokurimit(pranimi** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | **i kërkesave bëhet gjatë gjithë vitit)** |

| | |
|---|---|
| **Gjithsej vlera e subvencioneve:** | **600,000.00** |

1. **Subvencionimi i fermerëve me mekanizim bujqësor** – Drejtoria për Bujqësi për Vitin 2026 do të subvencionojë fermerët me mekanizim të ri bujqësor.Mekanizimi i ri bujqësor është mjeti i domosdoshëm për zbatimin e masave agroteknike te të gjitha kulturat bujqësore. Meqë është mjet i domosdoshëm, ai ndikon direkt në uljen e kostos së prodhimit dhe rritjen e të hyrave të qëndrueshme për ekonomitë familjare që mirren me këtë veprimtari. Vlera e tërësishme e këtij projekti do të jetë 185,000.00€

2. **Subvencionimi i shpezëtarëve prodhues vendor të vezëve për kokë pule** - Drejtoria për Bujqësi ka pranuar vazhdimisht kërkesa që të subvencionohet edhe kjo kategori prodhuese mirëpo deri në këtë vit nuk kemi arritur për shkak të mungesës së buxhetit.Duke pare rëndësinë e ketij sektori në zhvillimin ekonomik të vendit dhe duke ruajtur prodhimin vendor këtë vit do të subvencionojmë me nga 0,50 cent për kokë pule për të gjithë shpezëtarët që aplikojnë dhe plotësojnë kriteret e Mbpzhr-së.

3. **Subvencionimi i fermerëve prodhues të qumështit për liter qumështi të prodhuar-** Duke marrë vazhdimisht të dhëna nga tereni për sektorin e blegtorisë,dhe analizuar me kujdes mbi gjendjen e vështirë të prodhuesve të qumështit Drejtoria për Bujqësi për vitin 2026 do të bëjë subvencionimin e qumështit të prodhuar për 6 mujorin e parë të Vitit 2026 me vlerën prej 0.10 cent për litër të prodhuar.Procesi i subvencionimit do të bëhet përmes thirrjes publike për të gjithë prodhuesit e qumështit aplikues për sasi dhe cilësi të qumështit në Mbpzhr.Vlera investive për Vitin 2026 është 120,000.00€.

4. **Subvencionimi i fermerëve kultivues të perimeve në serra me paisje** - Duke marr për bazë kërkesat e shumta të fermerëve dhe duke parë rëndësinë e kultivimit të kulturave bujqësore në serra dhe jashtë tyre Drejtoria për Bujqësi këta kultivues këtë vit do t'i subvencionojë me paisje – mekanizim bujqësor për kryerjen e punëve në serra dhe jashtë tyre. Kultivimi i perimeve në serra dhe jashtë tyre kërkon angazhim të madh të fuqisë punëtore dhe pajisjet siç janë motokultivatorët me frezë e lehtësojnë dukshëm veprimtarinë e kësaj kategorie duke zvogëluar angazhimin e fuqisë puntore bazuar në mundësitë buxhetore Drejtoria për Bujqësi për Vitin 2026 ka paraparë që të ndajë 160,000.00 € për realizimin e këtij projekti.

5. **Kompenzimi i dëmeve nga fatkeqësitë natyrore** – bujqit në përgjithësi ballafaqohen me dëme që iu shkaktohen nga fatkeqësitë e ndryshme natyrore si nga reshjet e shiut, breshërit, vërshimet, përmbytjet dhe nga fatkeqësitë tjera si nga zjarri, ngordhjet te kafshët e trasha dhe të imëta,dëmet në bletishte etj.Meqë shumica dërmuese e bujqëve nuk i kanë të siguruar kulturat bujqësore dhe gjënë e gjallë(lopë,dele,dhi etj) Drejtoria për Bujqësi në bazë të mundësive të saj buxhetore edhe këtë vit ka ndarë një buxhet në

vlerë prej 100,000.00€ për kompenzimin e pjesërishëm të këtyre dëmeve.Kompensimi do të bëhet në bazë të vlerësimit profesional te komisionit të krijuar nga ana e Drejtorisë për Bujqësi.

**III**

Për realizimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës, Drejtoria për Financa dhe Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari.

**IV**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

**Xhavit Zariqi**